



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_278\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_424\_06\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_424\_06\_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 26.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Arsim Krasniqi (shifra e konsumatorit DPR – 36952) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 21.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 29.12.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 11.02.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik me nr. 11653989 e ka xhamin e thyer.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 264047 të datës 11.02.2009

- Me datë 04.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 11653989 dhe ka vendosur për matje njehsorin nr. 25257532.

**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000701 datë 04.03.2009

- Me datë 18.06.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 11653989, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori qelqin e ka të krisur, për rreth qelqit nga ana e epërme është futur shiriti filmik dhe është pengu puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 3/18 i datës 18.06.2009
- Me datë 24.06.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtim njehsori kanë shqyrtuar njehsorin elektrik me nr. 11653989 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar për matjen e energjisë elektrike.  
**Provë:** Protokolli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 02/6555 datë 24.06.2009
- Me datë 13.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se kanë dalur në vend të ngjarjes sipas procesverbalit të qendrës së kalibrimit nr. 6437 të datës 23.06.2009 dhe se ekipi i kalibrimit duhet të veprojnë sipas vërtetimit mbi ndërrimin e njehsorit elektrik pasi që pala ka hjek njehsorin e KEK-ut dhe se nuk ka shënime tjera për verifikim.  
**Provë:** Procesi i KEK-ut nr. 366977 të datës 13.08.2009
- Me datë 14.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatorit i është bërë ndërrimi njehsorit elektrik ku ekipi i ndërrimit të njehsorëve ka bërë ndërrimin. Pala e ka larguar njehsorin e KEK-ut dhe ka bërë kërkesë në KEK për lidhje të re, por që është udhëzuar që të bëhet vetëm ndërrim njehsori e jo lidhje e re.  
**Provë:** Procesi i KEK-ut nr. 366976 të datës 14.08.2009
- Me datë 16.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se me rastin e kontrollimit kanë marrë të dhënat teknike dhe pajisjet shtëpiake, njehsori është larguar dhe se pala ka vendos njehsor të ri.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 056605 të datës 16.10.2009
- Me datë 21.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe regjistrimin e pajisjeve që posedon konsumatori.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0123145 i datës 30.01.2008
- Me datë 21.11.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07988 në vlerë prej 456.44 €.  
**Provë:** Fatura DPR09HP07988 e datës 21.11.2009
- Me datë 19.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 29.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 19.12.2009
- Me datë 21.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_424\_06\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimin të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar